

Procesverbal

I hartuar më 20.05.2021 në debatin me banor e një pjese të qytetit , ku ishin te ftuare edhe banoret e fshatrave Letanc, Dumnicë e Poshtm, Llaushë, Dumnicë e Epërme, Përpellac, Shtedim, Livadic, Merdar dhe Miroc.

Temë diskutimi ishte; Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Podujevës.

Drejtori i Administratës në komunën e Podujevës Bahri Selimi i cili edhe u drejtoi debatin, i informoi të pranishmit mbi të gjitha procedurat e kësaj propozim rregulloreje, e cila është hartuar në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 mbi organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Në bazë të këtij udhëzimi administrativ komuna e Podujevës duhet ti formoi 30 këshilla lokale. Me propozim rregulloren komunale është paraparë që 24 këshilla lokale të formohen nëpër fshatra dhe 6 ne qytet. Këto janë vetëm propozime dhe pas debateve dhe propozimeve dhe kërkesave banorëve mund të ndryshohen.

Kjo propozim rregullore qysh ne vitin 2020 ka dal ne diskutim publik por për shkak pandemisë kovid 19 është shtyrë, po ashtu edhe ne vitin 2021 nga asambleja komuna është shtyrë për një kohe ma te përshtatshme. Në mbledhjen e fundit asambleja komunale e ka qit në diskutim publik.

Në kuadër të këtyre këshillave ka mundësi me bërë lëvizje të fshatrave nga një këshill ne tjetrin.

Jemi të vetëdijshëm se do kemi pakënaqësi dhe vështirësi rreth funksionalizimit te këtyre këshillave.

Ndërsa për rritjen e numrit të këshillave nuk na lejon udhëzimi administrativ theksoi Bahri selimi.

Bahri Selimi tha i kuptoi se nuk do të jetë e lehtë formimi i këshillave lokale, duke pas parasysh numrin e madh të fshatrave dhe pozitën gjeografike të komunës së Podujevës.

Do të kërkoj takim me ministrin e pushtetit lokal, do të ia paraqes të gjitha kërkesat e komuniteteve nëpër këto debate dhe do të kërkoj nga ministri ndryshimin e udhëzimit administrativ.

Deri sa të jete në fuqi ky udhëzim administrativ ne jemi të obliguar në bazë të tij.

Kërpimëh, më 20,05,2021

Procesmbajtësi

Latif Mehmeti